

PREZANTIM DHE DISKUTIM I PROJEKTLIGJIT MBI FALIMENTIMIN



Tiranë, 5 Tetor, 2015

Prof. Dr. Mariana Semini – Tutulani

Av. Vangjel Kosta

Prof. Dr. Arta Mandro

Dr. Genc Alimehmeti



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Departement of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

NJË FILLIM I RI

- Një karakteristikë e legjislacionit modern mbi falimentimin është që t'i japë debitorëve të mbingarkuar një “fillim të ri” për të ciluar pretendimet e kreditorëve të mëparshëm.
- Versioni i “fillimit të ri” tentohet të zbatohet për të gjithë debitorët përmes riorganizimit dhe ristrukturimit të borxhit. Kjo mundësi e fundit gërsheton zgjidhjet e vështirësive financiare përmes marrëveshjeve jashtëgjyqësore parafalimentare dhe është përfshirë në rregullimet e këtij drafti.
- Zgjidhje e paqartësive në lidhje me prioritetet në shpërndarjen e masës së falimentimit duke i garantuar kreditorëve të siguruar një pozicion të favorshëm.
- Nene të reja për të parandaluar mashtrimin në faliment duke maksimizuar vlerën.

Intervista

Takime Institucionale

- Min. e Drejtësisë, Min. e Financave, Min. e Zhv. Ekon, Tregtisë, QKR, AMF dhe DPTT

6 Modele Pyetësorësh
gjyqtarë; avokatë,
përmbarues,
administratorë, prokurore
dhe përfaqësues të
biznesit


METODOLOGJIA

Takime Informale
ekspertë, pedagogë të
fushës së falimentit,
avokatë, etj.;

5 Aktivitete Brainstorming

‘RRUGËTIMI’ I LEGJISLACIONIT “PËR FALIMENTIMIN” NË SHQIPËRI



- Nr.8901 datë 3.05.2002 “Për falimentimin”: Në fuqi më 1 Tetor 2002; i përbërë nga 284 nene; hartuar sipas modelit Gjerman;
- Ndryshimet me Ligjin nr.9919 date 19.05.2008 është shtuar pjesa në lidhje me krijimin e Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentimit;
- Ligji nr.10137, datë 11.05.2009, ndryshon vetëm nenin 43, pika 1 të ligjit 8901.(fjala liçensuar zëvendësohet me fjalën i çertifikuar)




ORIENTIMI NDËRKOMBËTAR

- Konventa e Organizatës Botërore të Punës (ILO) nr.173
- Direktiva 2002/74/EC mbi falimentimin
- Rregullore e BE-së për procedurat e falimentimit 1346/2000
- UNCITRAL (2005) Udhëzim mbi ligjin e falimentimit
- UNCITRAL (1997) Udhëzim mbi falimentimin ndërkombëtar
- Ligje të falimentimit të shteteve të veçanta: *SHBA, Gjermani, Itali, Mali i Zi, etj.*

Subjektet qe kerkojne falimentimin



Kohezgjatja e shqyrtimit te ceshtjes



Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Konfuzion me terminologjinë dhe konceptet. Mungojnë parimet.

- Vendosja e një **fjalorthi me 29 terma dhe koncepte**, të tilla si: ekspert i palës, kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë; masë e falimentimit; paaftësi paguese, etj. Po ashtu, **parashikohen parimet**: transparenca, shpejtësia, efektiviteti ekonomik, etj

Rrethi i subjekteve në procedurën e falimentimit si Debitor, është i ngushtë.

- Rrethi i subjekteve zgjerohet me: **familjen bujqësore, personat juridik publik, personat juridik jofitimprurës që ndjekin qëllime ekonomike, dhe njësitë administrative vendore.**
- ***Njësitë administrative vendore*** i nënshtrohen vetëm riorganizimit, pasi të **merret leja e KLSH.**
- Drafti parashikon edhe shtrirjen mbi pasurinë e **trashëgimlënësit, bashkëpronësinë e bashkëshortëve** sipas regjimit të bashkësisë ligjore dhe bashkësisë me kontratë, **pronën e përbashkët të një bashkësie të vazhdueshme** ose të një **bashkësie të administruar në mënyrë të përbashkët.**

Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Subjektet që ndjekin interesa publike, paraqesin vështirësi në lidhje me paaftësinë paguese.

- Procedura e falimentimit **nuk mund të hapet për subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorët me interes publik** dhe të caktuar si strategjikë.
- Nga momenti që subjekteve **u hiqet licenca** ata mund të jenë subjekte të ligjit të falimentimit.
- {...] çdo subjekt, ka të drejtë të kërkojë hapjen e procedurës së falimentimit, vetëm pasi të marrë **lejen paraprake nga autoriteti rregullator përkatës.**

Neni 104 të ligjit të tatimeve, krijon paralelizëm për rastin e hapjes së procedurës së falimentimit për subjektet me humbje.

- Sugjerohet **shfuqizimi i nenit 104 të ligjit për procedurat tatimore.** Drafti e parashikon këtë rregullim në dispozitat e tij, neni (21/3): “Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton me paaftësi paguese për një periudhë 3-vjeçare”.

Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Vështirësi në zgjidhjen e rasteve me pamjaftueshmëri të masës së falimentimit

- **“Fondi publik i posaçëm”** është fondi që administrohet nga AKF për të mbuluar shpenzimet e likuidimit në një procedurë falimentimi në rast të pamjaftueshmërisë të pasurisë së debitorit.

Pezullime dhe pushime të procedurës së falimentimit për shkak të mos mbulimit të shpenzimeve

- **Zgjerim i konceptit** të shpenzimeve gjyqësore:
 - shpenzimet gjyqësore;
 - paga e administratorit;
 - shpenzimet e komitetit të kreditorëve.
 - shpenzimet e veprimtarisë së administratorit;
 - detyrimet sipas kontratave të dyanshme, që duhet të paguhen pas hapjes së falimentimit;
 - detyrimet që vijnë nga begatimit pa shkak;

Mospërcaktim i qartë i shpërblimit të administratorit

1. Administratori i falimentimit ka të drejtën
 - **e pagës mujore,**
 - **të shpërblimit,**(% mbi sasinë e detyrimeve të shlyera nga masa e falimentimit,si edhe
 - **të rimbursimit për shpenzimet e bëra** gjatë përmbushjes së detyrës.
2. Paga vlerësohet **në varësi të vëllimit dhe të shkallës së vështirësisë.**
3. Rregullat e hollësishme lidhur me pagën & shpërblimin **caktohen me VKM.**
4. Paga, shpërblimi dhe shpenzimet që i rimbursohen administratorit të falimentimit **miratohen nga gjykata.**

Duhet forcuar statusi i AMF dhe kompetencat e saj

- AMF ka të të drejtë të ndjekë hetimin gjyqësor të çështjeve të falimentimit dhe nëse kërkohet nga gjykata, jep opinione dhe dëgjohet lidhur me përmbushjen e kompetencave dhe detyrave ligjore.
- Agjencia administron “fondin publik special”.
- Cakton depozitën e administratorit.
- Ka të drejtë në çdo kohë të kërkojë të dhëna të veçanta ose një raport të ndërmjetëm lidhur me gjendjen e planit.
- Njoftohet nga Gjykata jo më vonë se 5 ditë nga kërkesa për hapjen e procedurës si dhe përditësohet rregullisht mbi procedurën.

Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Konstatohen raste të abuzimit në falimentim, ndërkohë kur pranë prokurorisë nuk ka denoncime.

- Me marrjen e një kopjeje të vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit, **prokurori, me qëllim shmangien e abuzimit ose mashtrimit me procedurat e falimentimit, i kërkon administratorit të falimentimit që të verifikojë transfertat dhe veprimet juridike që lidhen me pasuritë e debitorit dhe të personave të lidhur me të, të kryera, të paktën tri vitet e fundit** përpara aplikimit për hapjen e procedurës së falimentimit.
- Për efekt të shmangies së abuzimit dhe mashtrimit në faliment , **specifikohet rrethi i “Personave të lidhur me debitorin”** me lidhje pasurore e jo pasurore me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, për shkaqefamiljare dhe bashkëjetese, etj.

Administratorët kanë vështirësi për marrjen e informacionit lidhur me pasuritë e debitorit

- Subjektet bankare, ZRPP, QKR, etj., **janë të detyruar t’i dorëzojnë administratorit të falimentimit të dhënat dhe dokumentet përkatëse për veprimet juridike të debitorit**

Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Konstatohen raste të abuzimit në falimentim, ndërkohë kur pranë prokurorisë nuk ka denoncime.

- Kur vendoset **shkarkimi i detyrimeve të pashlyera të debitorit (person fizik)** i jepet e drejta gjykatës së falimentimit të revokojë vendimin e shkarkimit të detyrimeve të pashlyera, kur debitori pengon apo fsheh pasuritë.
- Kërkesa e kreditorit mund të paraqitet brenda një viti nga koha kur kreditori ka marrë dijeni për shkeljen e një detyrimi, por në cdo rast jo më vonë se **gjashtë vjet nga dhënia e vendimit të shkarkimit të detyrimit.**

Mungon rregullimi ligjor i procesit të ristrukturimit të borxhit

- Debitori mund të kërkojë nga gjykata **miratimin e marrëveshjes për ristrukturimin e borxhit**, të arritur me pëlqimin e kreditorëve të cilët zotërojnë shumicën e masës së kredive të tij. Marrëveshja i komunikohet prokurorit.

Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Vështirësi nga rradha e preferimit e parashikuar nga neni 605 i Kodit Civil

- 1. Pretendimet e siguruara** deri në vlerën e pronës që shërben si garanci.
- 2. Pretendimet prioritare**, ku përfshihen:
 - pretendimet e lindura nga **përfundimi i marrëdhënies së punës për periudhën tre mujore**, por jo më shumë se 500 mijë lekë në total;
 - financimet e marra në formën e **huasë**;
 - pretendimet për **detyrimin për ushqim**;
 - pretendimet e punonjësve për **dëme ndaj jetës**;
 - pretendimet për **taksat e papaguara për vitin e fundit**;
 - **shpërblimi i administratorit** të falimentimit;
 - **detyrimet ndaj fondit publik të posaçëm**;
 - **shpenzimet e riorganizimit**.
- 3. Pretendimet e kreditorëve të tjerë të falimentimit**;
- 4. Pretendimet e rangjeve më të ulët**;
- 5. Pretendimet e ortakëve, aksionerëve, themeluesve, anëtarëve.**

Rregullimi ligjor i falimentimit ndërkufitar është jo i plotë

- Eshtë përdorur ligji model UNCITRAL (1997) mbi **falimentimin ndëkombëtar**.

Mungesa e penaliteteve

- Janë parashikuar kundravajtje administrative në rastet e:
 - Deklaratave që përmbajnë të dhëna të rreme.
 - **Fshehja, transferimi ose tjetërsimi i pasurisë ose dokumenteve** për administratorin ose gjykatën e falimentimit, me qëllim pengimin e procedurës së falimentimit.
 - **Moszbatimi i vendimeve ose urdhrave të gjykatës nga ana e administratorit.**
 - **Refuzimi i administratorit të falimentimit për të dorëzuar pasuritë dhe dokumentacionin përkatës** në rastin kur ai shkarkohet nga detyra.

Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Mungon parashikimi ligjor për konvertimin e procedurës nga riorganizim në likuidim

- Çdo kreditor ka të drejtë të kërkojë konvertimin e procedurës për:
 - mosshlyerjen e detyrimeve të maturuara;
 - njoftimit të administratorit mbikëqyrës mbi dështimin e debitorit për zbatimin e planit.
- Gjykata e falimentimit me kërkesën e administratori mbikëqyrës ose mbi ankimin e kreditorëve, pasi dëgjon debitorin, vendos konvertimin e procedurës nga riorganizimi në likuidim. Kundër këtij vendimi të ndërmjetëm mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit.

Mungon lidhja e procedurës së falimentimit me subjekte të posacme

Në lidhje me **bashkëshortët, në rastet e bashkësisë së vazhdueshme**, në lidhje me **trashëgiminë**;
Rasti i falimentimit **të thjeshtuar** dhe për **konsumatorën**.

Domosdoshmëria e detajimit të kompetencës tokësore dhe treguesve që lidhen me ato.

- Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe gjykohet në **gjykatën e falimentimit ku debitori ka qendrën e kryesore të interesit.**
- Nëse debitori e ka **transferuar qendrën e kryesore të interesit** në një vend tjetër, kompetenca tokësore është vetëm e gjykatës së falimentimit ku ndodhet **qendra e re** ose vendbanimi i ri.
- Nëse debitori **nuk ka qendër kryesore të interesit, seli ose vendbanim në Shqipëri**, kompetenca tokësore i përket gjykatës së falimentimit ku debitori ka një degë ose ka çdo pasuri tjetër.
- Në rast se një procedurë falimentimi **është deklaruar në kompetencë tokësore të disa gjykatave të falimentimit**, kompetente e drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes është gjykata ku është paraqitur fillimisht kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.

Konstatohen vonesa lidhur me juridiksionin e gjykatës së falimentimit.

Procedurat gjyqësore janë të gjata dhe i tejkalojnë afatet e parashikuara nga ligji ekzistues

- Gjykata e falimentimit **gjykon mbi aktet;**
- Gjykata e falimentimit **disponon me vendime & urdhra.**
- Vendimet dhe urdhrat e gjykatës **janë të ekzekutueshme menjëherë.**
- Ankimet ndaj vendimit nuk pezullojnë ekzekutimin e vendimit, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.
- Gjykata e falimentimit shqyrton dhe vendos lidhur me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit **jo më vonë se 60 ditë nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e gjykatës.**
- Gjykata e falimentimit, në varësi të natyrës së çështjes, e shqyrton çështjen ose gojarisht në seancë dëgjimore ose në dhomën e këshillimi mbi bazë aktesh shkresore.
- **Mosparaqitja e palëve në gjykim nuk e pengon shqyrtimin e çështjes.**

Domosdoshmëria e detajimit të hetimit gjyqësor dhe të procesit të ekspertimit

- Gjykata e falimentimit **heton kryesisht të gjitha rrethanat** që kanë lidhje me procedurën e falimentimit.
- Duke huazuar nga K.Pr Administrative, **futet koncepti: eksperti i palëve apo i gjykatës** dhe ka vetem nje séance qe sjell raportin apo aktin.
- Gjatë hetimit gjyqësor, gjykata e falimentimit mund të marrë si provë opinionin e **ekspertit të palës ose/dhe të ekspertit të caktuar nga vetë gjykata** e falimentimit.
- Bashkë me vendimin për kryerjen e ekspertimit, gjykata e falimentimit i **kërkon ekspertit të plotësojë dhe të nënshkruajë një deklaratë personale për dijeninë e tij për përgjegjësinë penale në rast ekspertimi të rremë dhe e fton që të bëjë betimin.**

Gjetje dhe Probleme

Zgjidhja nga Draft Ligji

Vonesa të shkaktuara nga gjykime paralele nga gjykata civile të çështjeve që ndërthuren me falimentimin

- Drafti parashikon **Juridiksion të Posacëm për gjykatën e falimentimit** për gjykimin e çështjeve që lidhen me masën e falimentimit, përfshirë por pa u kufizuar në:
 - vazhdimin e gjykimit të **padive të pezulluara** për shkak të hapjes së falimentimit;
 - paditë **për pavlefshmërinë e veprimeve** të debitorit;
 - paditë për **vërtetimin e pretendimeve të kreditorëve**.

Afate të gjata të gjykimit në apel

- Afati i **ankimit të veçantë** sipas këtij ligji, është 5 ditë.
- **Gjykata e Apelit, gjykon çështjen në dhomë këshillimi, si rregull, brenda 30 ditëve** nga data e regjistrimit të saj.
- Gjykata e Apelit, **përrjashtimisht, mund të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve**, në rast se vlerëson se duhen vërtetuar fakte të reja, marrë prova të reja si dhe për çështjet e juridiksionit të posaçëm të gjykatës së falimentimit.

Njoftimet individuale për cdo kreditor, si dhe mungesa e adresave të tyre, vonojnë procedurën e falimentimit.

- Njoftimet bëhen nga gjykata me shërbim postar të shpejtë ose **mjetet e komunikimit elektronik**, sipas K.Pr.C.
- **Shpalljet e bëra në mjediset publike dhe faqen zyrtare të gjykatës së falimentimit merren si njoftim i të gjithë palëve pjesëmarrësve në procedurën e falimentimit.**
- Gjykata e falimentimit ngarkon **administratorin të kryejë njoftimin për shpalljen publike në faqen zyrtare të debitorit** nëse ekziston një e tillë.
- Sekretaria e **gjykatës njofton A.K.F jo më vonë se pesë ditë** nga depozitimi i çdo kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit.
- Sekretaria e gjykatës **dërgon për publikim në Q.K.R** çdo vendim për hapjen, pezullimin, ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së falimentimit.

Pamjaftueshmëria e aseteve dhe prishja e shoqërisë për shkak të saj sjell shmangien e shlyerjes së kreditorëve.

•. LIGJ Nr. 129/2014 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9901/2008 PËR SHOQ.TREG. **Nenet 43/99/187/5:**

Prishja e shoqërisë, si pasojë e në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, vendoset nga gjykata e falimentimit, kur ... gjykata **vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit**, për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

•Drafti ka parashikuar vetëm **ndërprerjen e procedurës së falimentimit përmes pezullimit** në rast të pamjaftueshmërisë së masës së falimentimit për të mbuluar shpenzimet.

• **Procedura rifillon, sapo sigurohet fondi i mjaftueshëm** për mbulimin e kostove nëpërmjet fondit publik të posaçëm ose financimit të palëve të interesuara.

JU FALEMINDERIT!